



Stadi: 01/09/2017

Aplikim për vizë me qëllim kërkimin e një vendi pune (maksimumi deri 6 muaj)

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhënë bashkëngjitur. Duke qenë i/e përgatitur mirë ju mund të ndikoni pozitivisht dhe të shkurtoni procedurën përkatëse.

I gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet në origjinal!

Procedurat zgjasin zakonisht pak ditë pune, në raste të veçanta edhe më gjatë.

Të gjitha dokumentat që tërhiqen pranë Ambasadës (fletët e informacionit, formularët e aplikimit) janë gratis. Të gjitha informacionet rreth procedurës së aplikimit i gjeni në faqen e internetit të Ambasadës.

Lutemi të vini re udhëzimet e dhëna për çdo pikë, në mënyrë të veçantë numrin e kopjeve të nevojshme.		
1.	Pashaporta e udhëtimit <i>+ 2 kopje (të gjitha faqet e rëndësishme)</i>	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
2.	2x formularë aplikimi	Në gjermanisht ose anglisht, të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkuara personalisht.
3.	3x fotografi	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj.
4.	Tarifa	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhen kesh në monedhën shqiptare LEK . Tarifa është 75 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit.
5.	Curriculum Vitae (nëse kërkohet) <i>+ 2 kopje</i>	Curriculum Vitae i formuluar nga vetë aplikuesi, duke paraqitur në mënyrë të veçantë kualifikimin dhe eventualisht veprimtarinë profesionale të deritanishme.
6.	Shkresë motivimi <i>+ 2 kopje</i>	Shkresë motivimi e formuluar nga vetë aplikuesi për kërkimin e vendit të punës të planifikuar. Që këtë duhet të jetë e qartë, se për cilat fusha dhe vende pune interesoheni, ku dëshironi të aplikoni dhe ku do të banoni. Ju lutemi të përmendni edhe njohuritë tuaja të gjuhës gjermane, të sillni dëshminë përkatëse për to dhe – nëse nuk keni

		njohuri të gjuhës gjermane – të argumentoni përse nuk do të jenë të nevojshme.	
7.	Dëshmi kualifikimi <i>+ 2 kopje</i>	<p>Diplomë e shkollës së lartë gjermane apo e një vendi tjetër e njohur nga Gjermania, apo e krahasueshme me një të tillë.</p> <p>Nëse diploma juaj e shkollës së lartë është e krahasueshme me një diplomë gjermane dhe nëse shkolla e lartë përkatëse njihet si e tillë në Gjermani, këtë mund ta verifikoni në Bazën e të Dhënave ANABIN: http://anabin.kmk.org/ – duhen paraqitur te dy konfirmimet e printuara.</p> <p>Nëse diploma juaj / shkolla e lartë nuk është e regjistruar në këtë Bazë të Dhënash, atëherë duhet të bëni vlerësimin e diplomës suaj nga Zyra Qendrore për Arsimin me Jashtë (ZAB): http://www.kmk.org/zab/zeugnisbewertungen-fuer-auslaendische-hochschulqualifikationen.html</p>	
8.	Dëshmi për mundësi të mjaftueshme financimi të gjithë të qëndrimit <i>+ 2 kopje</i>	<p>Dëshmi e mundësive të financimit për gjithë kohëqëndrimin (shuma minimale e kërkuar 720 euro), ndër të tjera në formën e një deklaratë garancie <u>ose</u> përmes derdhjes së shumës përkatëse në një llogari bankare të bllokuar. Për këtë qëllim shihni informacionet përkatëse në faqen e internetit të Ambasadës Gjermane www.tirana.diplo.de</p>	
9.	Dëshmi për një siguracion shëndetësor të mjaftueshëm <i>+ 2 kopje</i>	<p>Dëshmia për siguracionin shëndetësor për të gjithë kohëqëndrimin duhet të paraqitet në gjatë tërheqjes së vizës.</p>	

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.